

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NE DEPARTAMENTIN E TË ARDHURAVE DHE KONTROLLIT TË TERRITORIT, BASHKIA KORÇË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Departamentin e të Ardhurave dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Korçë, me objekt “Mbi realizimin e të ardhurave vendore dhe zbatimin e legjislacionit për programimin e vjeljen e taksave dhe tarifave vendore” për periudhën nga data 01.01.2012-31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 122, datë 19.09.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 576/14, datë 19.09.2014 Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, i janë dërguar z. Sotiraq Filo, Kryetar i Bashkisë, Korçë.

Ky auditim u shqyrtua dhe u vlerësua në të ftohtë për problematikën e ngritur në letrën drejtuar KLSH me nr. 576/3, datë 04.08.2014 nga zj. Tatjana Marsh, drejtore e Klubit Shumë sportesh “Skënderbeu”, për subjektin Departamenti i të Ardhurave dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Korçë, nga Grupi i Kontrollit ngritur me Urdhrin nr. 95, datë 11.09.2014 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, konkluzionet e të cilit janë miratuar me Vendimin nr. 121, datë 19.09.2014, të Kryetarit të KLSH dhe janë pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit në Departamentin e të Ardhurave dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Korçë, si pikë e veçantë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi dhe analiza e të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifave vendore, sipas zërave të përcaktuara në programet përkatëse, për të dy vitet e marra së bashku (2012, 2013) rezultoi: një diferencë **në vlerë 307,927 mijë lekë**, e cila ka ardhur kryesisht nga mos funksionimi i plotë i sektorëve në përbërje të Departamentit të Ardhurave dhe Kontrollit të Territorit, si dhe nga mungesa e bashkëpunimit ndërmjet tyre. Këto veprime bien ndesh me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 2, pika 1 dhe 5, neni 16 “Të ardhurat e veta të komunës dhe të bashkisë”, gërmat a, b, c dhe ç, kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 4, “Zbatimi i Sistemit Tatimor në Republikën e Shqipërisë”, pikat 1,2,3,4,5,6 dhe 7, si dhe kërkesat e udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Brendshëm nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”, i ndryshuar. *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 16-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:*

Departamenti i të Ardhurave dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Korçë, të marrë masa konkrete për të përmirësuar funksionet e Sektorëve dhe forcimin e bashkëpunimit midis tyre, me qëllim rritjen e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit të punës kontrolluese nga specialistët e kontrollit në terren dhe specialistja e menaxhimit të borxhit të keq. Për këtë qëllim të përgatiten programe pune mujore, tremujore dhe vjetore, të miratuara nga Titullari, me qëllim që; risku të evidentohet në mënyrë të dokumentuar gjatë kontrolleve të programuara, për mbledhjen e të ardhurave dhe menaxhimin e borxhit të keq.

2. Specialistët e kontrollit në terren dhe specialistja e menaxhimit të borxhit të keq gjatë kontrollit të ushtruar kanë konstatuar disa subjekte, të cilët mbas kontrollit kanë rezultuar me detyrime debitorë të papaguara, por që deri në momentet e kontrollit nuk janë ndëshkuar asnjëherë me sanksione në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë.” *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 48-58 dhe 69-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:*

Departamenti i të Ardhurave dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Korçë, të marrë masa që të gjithë subjektet debitorë të pa ndëshkuar, të evidentuar nga specialistët e kontrollit në terren dhe specialistja e borxhit, të trajtohen me masa shtrënguese konkrete, me qëllim rikuperimin e borxhit të keq, për të gjithë subjektet debitorë të vitit 2012 dhe 2013, me vendosje të sekuestrove ekzekutive deri në konfiskimin e pasurisë, si edhe nëpërmjet transferimeve të detyrimeve tatimore palëve të treta.

3. “Specialistja e administrimit të borxhit të keq nuk disponon regjistra analitik ku të ketë regjistruar tatimpaguesit debitorë (borxhi i keq), për subjektet fizikë dhe juridikë, në juridiksionin e Bashkisë Korçë, objekt i pagesës së taksave dhe tarifave vendore, sipas viteve të borxhit”, të dhënat e administruara në mënyrë elektronike nuk janë të arkivuara me inventarë të rregullt, në arkivin e bashkisë. *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 48-58 dhe 69-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:*

Departamenti i të Ardhurave dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Korçë, krahas mbajtjes dhe administrimit të të dhënave në sistem elektronik, specialistja e menaxhimit të borxhit të keq të përgatisë regjistrin e tatimpaguesve debitor (*borxhi i keq*) në mënyrë analitike dhe për të gjitha subjektet fizike dhe juridike objekt i pagesës së taksave dhe tarifave vendore, ku përveç NIPT-it, llojit të aktivitetit dhe adresës përkatëse, të pasqyrohen dhe detyrimet vjetore sipas llojit të taksës e tarifës, afatet e pagesës së detyrimit të përputhen me afatet e përcaktuar me ligj, duke regjistruar numrin dhe datën e pagesës. Në fund të çdo viti është e domosdoshme që regjistri të printohet dhe të arkivohet në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

4. Detyrimet debitorë (borxhi i keq), kanë ardhur çdo vit në rritje të pandërprerë duke u dyfishuar në fund të vitit 2013, për arsye se masat shtrënguese, përfshi sekuestrimi dhe konfiskimin e mallrave, pothuajse nuk janë zbatuar, ky veprim bie ndesh me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 88, autoriteti dhe kompetencat për mbledhjen e detyrimit tatimor të papaguar. *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 48-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:*

Departamenti i të Ardhurave dhe Kontrollit të Territorit, nëpërmjet Specialistes së menaxhimit të borxhit të keq, të marrë masa me qëllim rikuperimin e vazhdueshëm të detyrimeve debitor gjendje, e cila më datë 31.12.2013 paraqitet e analizuar, për vitin 2012 me 740 subjekte për 2195 raste (*taksa e tarifa*) në vlerë **35, 078, 463 lekë** dhe për vitin 2013 me 797 subjekte për 4970 raste (*taksa e tarifa*) në vlerë **71,991,139 lekë** të ardhura të munguara.

5. Bashkëpunimi, ndërmjet sektorëve brenda për brenda departamentit dhe ndërmjet drejtorive pranë bashkisë (Policia Bashkiake, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit etj) nga auditimi i ushtruar mbi dokumentet e paraqitur ka rezultuar inegzistent, mbasi nuk gjendet asnjë gjurmë e këtij bashkëpunim, në drerjtimit të zbatimit të detyrave të ngarkuara Këshilli i Bashkisë. Këto veprime bien ndesh me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 2, pika 1 dhe 5, neni 16 “Të ardhurat e

veta të komunës dhe të bashkisë”, germat a, b, c dhe ç, si dhe kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 4, “Zbatimi i Sistemit Tatimor në Republikën e Shqipërisë”, pikat 1,2,3,4,5,6 dhe 7.” *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 16-48 dhe 58-69, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:*

Departamenti i të Ardhurave dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Korçë, të marrë masa të plota ligjore për rritjen e nivelit të funksionimit të sektorëve, nëpërmjet bashkëpunimit të përhershëm në mes tyre, si dhe fuqizimit të bashkëpunimit në rrugë ligjore me Drejtoritë që funksionojnë pranë bashkisë, për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, si dhe të legjislacionit për programimin e saktë, transparent e të përgjegjshëm të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, në total dhe në strukturë.

6. Sektori i të Ardhurave dhe Specialistët e Kontrollit të Territorit, nuk i kanë realizuar plotësisht programet e kontrollit të vetë përgatitura, duke krijuar kështu mundësi dhe hapsira, që disa subjekte të kryejnë evazion fiskal duke krijuar nga disa taksa dhe tarifa vendore deficite të theksuara në të ardhurat e bashkisë. Këto veprime bien ndesh kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000“Për organizimin dhe dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 2, pika 1 dhe 5, neni 16 “Të ardhurat e veta të komunës dhe të bashkisë”, germat a, b, c dhe ç, si dhe kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 4, “Zbatimi i Sistemit Tatimor në Republikën e Shqipërisë”, pikat 1,2,3,4,5,6 dhe 7. *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 16-47 dhe 69-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:*

Departamenti i të Ardhurave dhe Kontrollit të Territorit Bashkia Korçë, të marrë masa që Sektori i Mbledhjes së të Ardhurave, Specialistët e Kontrollit të Territorit, të hartojnë programe kontrolli plota mujore, katër mujore dhe vjetore, pa neglizhuar programet e kontrolleve tematike dhe të befasishme, për ato subjekte ku risku i kontrollit konsiderohet tej kufijve normal me rreqe të theksuara në drejtim të realizimit të ardhurave vendore nga subjekte të ndryshme. Njëkohësisht të punohet për të plotësuar dhe sistemuar të gjithë dokumentacionin përkatës (regjistrat rajonalë) sipas zonave dhe objekteve të kontrollit.

7. Departamenti përkatës, nuk ka bërë përpjekjet e duhura, në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin Bashkiak, për të rritur dhe fuqizuar nivelin e bashkëpunimit me agjentët tatimor, ZVRPP, DRSHTRR dhe ALUIZNIN. *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 16-47 dhe 69-71, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:*

Departamenti i të Ardhurave dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Korçë, të kërkojë në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak që të caktohen detyra konkrete dhe të ndërmerren hapa ligjore për nënshkrimin e marrëveshjeve me agjentët tatimor si; **ZVRPP, DRSHTRR, ALUIZNI** etj, duke shtuar një kapitull me sanksione përkatëse, për secilën palë, mbasi marrëveshjet e vjetra nuk kanë fuqi ligjore, por as sanksione përkatëse dhe si të tilla nuk kanë efekte ligjore. D.A.K.T, duhet të monitorojë hap pas hap i performancën e agjentëve tatimorë me të cilët janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, ajo nuk duhet të mjaftohet vetëm me përgatitjen dhe nënshkrimin e akteve të rakordimit mujor, por duhet të marrë masa të menjëhershme me grupe pune të përbashkëta për realizimin e të ardhurave të programuara nga Këshilli Bashkiak Korçë.

8. Bashkia Korçë, që nga viti 2008 e deri në fund të vitit 2013, të ardhurat nga taksa e pasurisë, tarifa e pastrimit dhe heqjes së mbeturinave, e ndriçimit dhe e gjelbërimit, i ka kontraktuar me

marrëveshje me Ndërmarrjen e Ujësjetës Kanalizimeve Korçë bazuar në numrin e familjeve që kanë të regjistruar një sahat uji, të cilat variojnë nga 16-19 mijë familje. Ky numur familjesh në raport me numrin e familjeve që gjenden në Zyrën e Gjendjes Civile të Bashkisë është nga 12-9 mijë familje më i madh, pra nuk kemi një numur të saktë të familjeve rezidente në qytetin e Korçës. *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 48-69, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:*

Departamenti i të Ardhurave dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Korçë, të marrë masa për inventarizimin e plotë të numrit të familjeve që banojnë, ose zotërojnë prona në juridiksionin e bashkisë dhe të bëjnë regjistrimin e tyre në një “*datebase*” të veçantë e të aksesueshëm, i cili të përmbajë shtesat dhe paksimet vjetore të numrit të familjeve, që do të shërbejë si një bazë e rëndësishme, për të gjitha programimet e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, që kanë për bazë llogaritje, numrin e familjeve.

9. *Numri i familjeve rezidente në qytetin e Korçës, mbi bazën e të cilave janë programuar të ardhurat nga segmenti familjarë, për tarifën e ndriçimit, pastrimit dhe gjelbërimit, si dhe taksën e pasurisë, nuk përputhen me numrin e familjeve që janë të regjistruara në Zyrën e Gjendjes Civile, pranë Bashkisë Korçë” Në këto kushte të ardhurat nga taksa e pasurisë, tarifa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit duhet të ishin programuar në vlerë **119,005 mijë lekë** më shumë e konkretisht; nga taksa e Pasurisë **33,648 mijë lekë**, nga tarifa e Ndriçimit **20,080 mijë lekë**, nga tarifa e Pastrimit dhe heqjes së mbeturinave **50,934 mijë lekë** dhe nga tarifa e Gjelbërimit **14,343 mijë lekë**. Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 58-69, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:*

Departamenti i të Ardhurave dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Korçë, të marrë masa konkrete, për analizimin e shkaqeve që kanë sjellë mosrakordimin e numrit të familjeve bazuar në regjistrat e Zyrës së Gjendjes Civile pranë bashkisë dhe numrit të familjeve të regjistruara nga agjenti tatimor UKKorçë, mbi bazën e të cilave ai ka bërë llogaritjen e të ardhurave nga taksa pasurisë, tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe të gjelbërimit, që nga viti 2008.

10. Mos realizimi i të ardhurave nga Taksat dhe Tarifatat Vendore gjatë viteve 2012 dhe 2013 nuk është marrë asnjëherë në analizë nga Këshilli i Bashkisë, lidhur me shkaqet që kanë penguar mos realizimin e të ardhurave duke nxjerr përgjegjësi individuale të shoqëruara me masa administrative, me qëllim rritjen efektivitetit të punës së departamentit për ti realizuar sa më mirë treguesit e të ardhurave vendore. *Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 16-47 dhe 58-69, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:*

Departamenti i të Ardhurave dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Korçë, të marrë masa konkrete, për të përfshirë në axhendën e Këshillit të Bashkisë një raport të hollësishëm të përgatitur nga Drejtori i Departamentit të Ardhurave dhe Kontrollit të Territorit, mbi analizimin e shkaqeve që kanë ndikuar në mos zbatimin e plotë të legjislacionit për realizimin e të ardhurave nga Taksat dhe Tarifatat Vendore, si dhe mangësitë procedurale që janë konstatuar gjatë auditimit të disa programimeve të pasakta të të ardhurave dhe mos realizimi i tyre për periudhën 2012-2013, me një diferencë në vlerë **307,927 mijë lekë**.

11. Gjatë periudhës së audituar (2012, 2013), Klubi Shumë sporte “Skënderbeu nuk ka realizuar të ardhura nga asnjë lloje sporti me pretendime të ndryshme se: Salla e Lojërave me dorë është e ftohtë ndaj spektatorët nuk janë ofruar dhe për ndeshjet e luajtur nuk ka pasur shitje

4. [REDACTED], me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Mbledhjes së të Ardhurave.

-Për mos zbatimin e detyrave funksionale, në drejtim të mbledhjes së të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore; nuk kanë vendosur gjopa ndaj subjekteve, që kanë vetë konstatuar me shkelje, për një rikuperim sa më të shpejtë dhe pa kosto të borxhit të keq, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”; nuk kanë marrë masat e duhura për rikuperimin me forcë të borxhit, që nga masat shtrënguese, vendosja e sekuestrove ekzekutive e deri tek konfiskimi i mallrave.

5. [REDACTED], Specialist i nivelit të lartë në sektorin e mbledhjes së të ardhurave,

6. [REDACTED], Specialiste i nivelit të mesëm në sektorin e mbledhjes së të ardhurave,

7. [REDACTED], Specialiste i nivelit të mesëm në sektorin e mbledhjes së të ardhurave për vitin 2012.

-Pasi nuk kanë vendosur gjopa ndaj subjekteve, që vetë kanë konstatuar me shkelje, për një rikuperim sa më të shpejtë dhe pa kosto të borxhit të keq, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”; nuk kanë marrë masat e duhura për rikuperimin me forcë të borxhit, që nga masat shtrënguese, vendosja e sekuestrove ekzekutive e deri tek konfiskimi i mallrave.

8. [REDACTED] Inspektor i tregut industrial dhe fruta perimeve,

9. [REDACTED] Specialist i nivelit të lartë në sektorin jo ushqimor dhe liçensimit,

10. [REDACTED], Specialist i nivelit të lartë, për vitin 2013.

-Pasi nuk kanë kryer kontrole tematike dhe të befasishme, për të verifikuar nivelin e zënies së hapësirave publike nga subjektet e tregut industrial dhe fruta-perimeve; nuk kanë aplikuar sanksione, ndaj subjekteve që shkelin kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar duke zënë hapësirat publike.

11. [REDACTED], Inspektor në terren për vjeljen e tarifës së parkimit.

-Pasi nuk ka realizuar të ardhurat nga “taksa e parkimit”, e cila për të dy vitet e marra së bashku është realizuar në vlerë 5,500 mijë leke, ndërsa në vitin vetëm në vitin 2010 ajo është realizuar në vlerë 4,233 mijë lekë; nuk ka ushtruar kontrole, lidhur me parkimin real të mjeteve në kohën dhe në hapësirën e duhur, të çdo vend parkimi.

12. [REDACTED], me detyrë specialiste e nivelit të mesëm për menaxhimin e borxhit të keq.

-Pasi nuk ka hartuar “*data base*” për subjektet debitore, lidhur me borxhin e keq të krijuar në Departamentin e të Ardhurave dhe Kontrollit të Territorit; nuk ka marrë masa për rikuperimin me forcë të borxhit të keq, nëpërmjet rritjes së masave shtrënguese.

13. [REDACTED] me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Korçë,

14. [REDACTED], me detyrë Specialist i nivelit të lartë në Drejtorinë e planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Korçë.

-Nuk kanë dërguar në Drejtorinë e të Ardhurave, informacione të vazhdueshme për pagimin e tarifës së pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit nga subjektet ndërtuese në bazë të kontjereve të ngritura, deri në momentin e aplikimit për pajisjen me leje shfrytëzimi.

Për 4 punonjës të cilesuar në Raportin Perfundimtar të Auditimit nuk rekomandohet masë disiplinore, pasi kanë shkëputur marrëdhëniet e punës me institucionin.

biletash. Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 36-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Departamenti i të Ardhurave dhe Kontrollit të Territorit, Bashkia Korçë, të analizojë arsyet e mos realizimit të të ardhurave nga Klubi Shumë Sporte “Skënderbeu” Korçë, për rezultatet e arritura të informohet Këshilli Bashkisë Korçë, me qëllim përmirësimin e gjendjes nëpërmjet masave konkrete.

B. MASA PER SHPERBLIM DEMI

Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej **14,872,000 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

1. Vlera prej **13,820,000 lekë** nga subjektet; sipas Aneksëve 3, 3/1, 3/2 dhe 3/3, trajtuar në RPA faqe 36-47, për mos llogaritjen dhe mos arkëtimin e detyrimeve të lindura nga tarifa e pastrimit dhe heqjes së mbeturinave, tarifa e ndriçimit dhe tarifa gjelbërimit, bazuar mbi lejet e ndërtimit të nxjerra nga Bashkia në vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2011.

2. Vlera prej **1,052,000 lekë**, nga **7 subjekte**, trajtuar në RPA faqe 36-47, për mos llogaritjen dhe mos arkëtimin të detyrimeve të lindura nga taksa e pasurisë, llogaritur më pak sipërfaqe ndërtimi, se sa ka rezultuar në fakt.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Korçë, që në vlerësim të shkeljeve të përshkruara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të bëjë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për dhënien e masave disiplinore, nga “**vërejtje**” deri në “**largim nga puna**”, sipas VKM nr. 115, datë 05.03.2014 dhe ligjit nr. 152/2013, për **14 punonjës** të Bashkisë Korçë.

1. Për [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjës i tregut industrial dhe fruta perimeve.

-Për mos zbatimin e detyrave funksionale, në drejtim të mbledhjes së të ardhurave nga taksa e zënies së hapësirave publike, të cilat për të dy vitet e marra së bashku janë realizuar në masën 28 %, me diferencë në vlerë 14,682 mijë lekë; nuk ka kryer kontrole tematike dhe të befasishme, për të verifikuar nivelin e zënies së hapësirave publike nga subjektet e tregut industrial dhe fruta-perimeve; nuk ka aplikuar sanksione, ndaj subjekteve që shkelin kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar duke zënë hapësirat publike.

2. z. [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit jo ushqimor e liçensimit, viti 2012, dhe

3. z. [REDAKTUAR] specialist i Nivelit Lartë në Sektorin e Kontrollit jo ushqimor e liçensimit, viti 2012.

-Pasi, nuk kanë kryer kontrole tematike dhe të befasishme, për të verifikuar nivelin e zënies së hapësirave publike nga subjektet e tregut industrial dhe fruta-perimeve; nuk kanë aplikuar sanksione, ndaj subjekteve që shkelin kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar duke zënë hapësirat publike.

Shenim: Auditimi u krye nga audituesit Livan Ho xha, p/grupi dhe Vladimir Rizvani, më tej u shqyrtua nga Kryeauditues z. Albert Thoma, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit znj. Albana Agolli si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm, znj. Luljeta Nano.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

Bashkia Korçë, me shkresën nr. 453/11, datë 22.10.2014 ka kthyer përgjigje për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga ku rezulton se është marrë në analizë nga strukturat drejtuese të Departamentit të të Ardhurave dhe Kontrollit të territorit në Bashkinë Korçë dhe është hartuar një Plan Veprimi “Për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga KLSH”, i miratuar nga Kryetari i Bashkisë, ku janë vlerësuar dhe janë marrë masat përkatëse për zbatimin e masave organizative të propozuara. Është vendosur të kërkohen në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej 14,872,000 lekë të rekomanduara, si dhe kanë filluar procedurat për dhënien e masës disiplinore për 12 punonjës me Urdhërin nr. 225, datë 29.09.2014.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT